

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Menaxhment Financiar**  
**(zgjidhjet)**

**P7**

Nr.		FLETË PROVIMI Exam Paper

Data: 01.02.2020

CONTENT / PËRMBAJTJA

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i dhënë i pikëve</b>	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- <b>PIKËT E DHËNA</b>
1. Problemi 1	25	
2. Problemi 2	25	
3. Problemi 3	25	
4. Problemi 4	25	
<b>Total</b>	100	

## Problemi 1

ABC sh. p. k. është i materialeve për shtrimin e dyshemeve. Kompania blen 20,000 paketa me materiale për shtrimin e dyshemesë çdo vit nga furnitori i tij, XIX sh. p. k. të cilat më pas i shet tek klientët e saj. Materialet prej druri origjinal për shtrimin e dyshemesë që blihen nga XIX sh. p. k. kushtojnë € 35 për paketë. Për çdo porosi të dhënë ka një shpenzim të përpunimit të mandat - blerjes (porosisë) me vlerë € 150 për porosi pavarësisht nga sasia e paketave të porositura, dhe XIX sh. p. k. i duhen 10 ditë për t'ia dorëzuar ABC – së materialet për shtrimin e dyshemesë. Kostoja mesatare e mbajtjes së një pakete me material për shtrimin e dyshemesë për një vit është € 9.

Një furnitor i ri i materialeve prej druri origjinal për shtrimin e dyshemesë, SENA sh. p. k., i ka ofruar ABC sh. p. k. materiale druri për shtrimin e dyshemesë duke iu përmbajtur disa kushteve disi të ndryshme. SENA sh. p. k. garanton se kurrë nuk do të ketë dëmtime të materialit, meqenëse përdor materiale speciale të paketimit që janë krijuar për mbrojtje maksimale. Ai ngarkon € 34.95 për secilën paketë për materiale për shtrimin e dyshemesë. Përsëri ka një shpenzim për përpunimin e porosisë me vlerë € 160 për porosi, pavarësisht nga sasia e paketave të porositura, dhe SENA sh. p. k. do 7 ditë të dorëzojë mallrat. Kostoja mesatare e mbajtjes së një pakete me materiale prej druri të vërtetë për shtrimin e dyshemesë të blera nga SENA sh. p. k. për një vit është € 12. Ndodh kështu sepse paketimi special kërkon edhe më shumë hapësirë për t'u ruajtur.

*Kërkohet:*

(a) Sipas marrëveshjes me furnitorin aktual, llogarisni:

- (i) sasinë e porosisë ekonomike (SPE) për paketime të materiale prej druri për shtrimin e dyshemesë; (3 pikë)
- (ii) koston totale (porositja, blerja dhe mbajtja) të ruajtjes në stoqe të materialeve prej druri për shtrimin e dyshemesë për një vit. (4 pikë)

(b) Për furnitorin e ri llogarisni:

- (i) sasinë e porosisë ekonomike për paketim të materialeve prej druri për shtrimin e dyshemesë; (3 pikë)
- (ii) koston totale (kostoja e porositjes, blerjes dhe mbajtjes) të ruajtjes në stoqe të materialeve prej druri për shtrimin e dyshemesë për një vit (4 pikë)

ABC sh. p. k. ka vendosur të **MOS ndërrojë furnitorin** dhe informon SENA sh. p. k. për vendimin e saj. SENA sh. p. k. tani i ofron ABC një zbritje për blerje me shumicë prej 1 % për të gjitha porositë prej 2,000 ose më shumë paketa me materiale druri.

*Kërkohet:*

(c) Llogarisni dhe arrini në përfundimin e duhur për sa i takon faktit nëse ia vlen të pranohet porositja e menjëhershme e 2,000 paketave nga SENA sh. p. k.. (5 pikë)

(d) Parashtroni tre faktorë jo – financiarë të cilët duhet të mbahen parasysh gjatë kohës kur merren vendime mbi faktin nëse duhet apo nuk duhet të ndryshohet furnitori [pra në vend të XIX sh. p. k. të sillet SENA sh. p. k.]. (6 pikë)

(Totali: 25 pikë)

## Zgjidhja e problemit 1

### (a) Furnitori aktual

#### (i) SPE:

$$\begin{aligned} \text{Sasia e Porosisë Ekonomike} &= \frac{\sqrt{2} \times 150 \times 20\,000}{9} \\ &= 816 \end{aligned}$$

#### (ii) Kostoja totale:

Kostot e mbajtjes: stoqet mesatare x kostot e mbajtjes për njësi  
=  $(816 \div 2) \times \text{€ } 9 = \text{€ } 3,672$ .

Kostot e porositjes = numri i porosive x € 150

Numri i porosive = kërkesa vjetore ÷ Sasia e Porosisë Ekonomike  
=  $20,000 \div 816 = 24.5$

Në këtë mënyrë kostot e porositjes = € 3,675 në vit.

Kostot e blerjes =  $20,000 \times \text{€ } 35 = \text{€ } 700,000$ .

Kostoja totale për një vit = € 3,672 + € 3,675 + € 700,000 = € 707,347

### (b) Furnitori i ri

#### (i) Sasia e Porosisë Ekonomike

$$\begin{aligned} \text{Sasia e Porosisë Ekonomike} &= \frac{\sqrt{2} \times 160 \times 20\,000}{12} \\ &= 730 \end{aligned}$$

#### (ii) Kostoja totale:

Kostot e mbajtjes: stoqet mesatare x kostot e mbajtjes për njësi  
=  $(730 \div 2) \times \text{€ } 12 = \text{€ } 4,380$ .

Kostot e porositjes = numri i porosive x € 160

Numri i porosive = kërkesa vjetore ÷ Sasia e Porosisë Ekonomike  
=  $20,000 \div 730 = 27.4$

Në këtë mënyrë kostot e porositjes = € 4,384 në vit.

Kostot e blerjes =  $20,000 \times \text{€ } 34.95 = \text{€ } 699,000$ .

Kostoja totale për një vit = € 4,380 + € 4,384 + € 699,000 = € 707,764

### (c) Zbritjet

Kostot e mbajtjes =  $(2,000 \div 2) \times \text{€ } 12 = \text{€ } 12,000$ .

Kostot e porositjes =  $(20,000 \div 2,000) \times \text{€ } 160$   
= € 1,600.

Kostot e blerjes = € 699,000 x 99 %  
= € 692,010.

Kostoja totale për një vit = € 12,000 + € 1,600 + € 692,010  
= € 705,610.

Zbritja bën që t'ia vlejë të ndryshohet furnitori.

(d) Faktorët jo - financiarë

- Cilësia e drurit të SENA sh. p. k. Mund të mos jetë aq e mirë sa është ajo e drurit të XIX sh. p. k. - së, megjithëse duhet të jetë po aq cilësore meqenëse ndryshimi në çmime është shumë i vogël. Druri i ri duhet të inspektohet për të bërë të sigurt se është i të njëjtës trashësi si druri tjetër.
- Besueshmëria e SENA sh. p. k.. SENA sh. p. k. duket se ka një kohë më të shkurtër për përmbushjen e porosisë (shtatë ditë në vend të 10 ditëve) por në qoftë se nuk do të jenë të aftë të dërgojnë stoqet siç duhet çdo herë, ABC sh. p. k. mund të mbetet edhe pa stoqe. Një gjë e tillë do të thotë që klientët do të shkojnë diku tjetër, gjë që do të bëjë që kompania të mbetet pa stoqe.
- Paketimi i drurit të SENA sh. p. k.. Paketimi i SENA sh. p. k. duhet të duket tërheqës, përndryshe klientët nuk do ta blejnë atë. Përveç kësaj, ai duhet të mbrojë siç duhet drurin, ashtu siç pretendon garancia.
- Ka shumë lloje të ndryshme të drurit, p.sh. ahu, panja dhe lisi. ABC sh. p. k. duhet të bëjë të sigurt se furnitori i ri është në gjendje të ofrojë të gjitha llojet e drurëve që aktualisht janë në stoqe.
- Politika për kthimet e mallit. SENA sh. p. k. duket se ofron një garanci për sa i takon faktit se druri do të arrijë i padëmtuar por ABC sh. p. k. ende mund të duhet të kthejë mallra. Në këtë mënyrë duhet të kuptohet mirë politika për kthime e SENA sh. p. k. dhe fakti se deri ku kjo kompani është e gatshme të trajtojë problemet përkatëse.

## Problemi 2

ABC sh. p. k. planifikon të blejë një makineri të re për të përmbushur kërkesën e pritur për një produkt të ri, Produkti "X". Kjo makineri do të kushtojë € 250,000 dhe do të mund të përdoret për katër vjet, dhe në fund të kësaj periudhe do të mund të shitet për € 5,000. ABC sh. p. k. pret që kërkesa për Produktin të jetë si vijon:

Viti	1	2	3	4
Kërkesa "X" (njësi)	35,000	40,000	50,000	25,000

Çmimi i shitjes për Produktin "X" pritet të jetë € 12.00 për njësi dhe kostot variabël për prodhimin e tij pritet të jenë € 7.80 për njësi. Dihet se do të ndodhin shpenzime të përgjithshme fikse vjetore të prodhimit me vlerë € 25,000 në vit. Çmimi i shitjes dhe kostot janë të gjitha të shprehura me anë të çmimeve aktuale.

Çmimi i shitjes dhe kostot pritet të rriten si vijon:

	Rritja
Çmimi i shitjes të Produktit "X"	3 % në vit
Kostot variabël të prodhimit:	4 % në vit
Shpenzimet e përgjithshme fikse të prodhimit:	6 % në vit

### Informacionet e tjera

ABC sh. p. k. ka një *kosto (norma) reale të kapitalit prej 5.72%* dhe paguan tatime me një normë vjetore prej 30%, *një vit pasi realizon fitimin*. Kompania mund të kërkojë *lejime kapitale prej 25 %* të llogaritura mbi bazën e *tepricave që reduktohen*. Inflacioni i përgjithshëm **pritet të jetë 5%** në vit. ABC sh. p. k. ka një normë të synuar të kthimit nga kapitali i përdorur prej 20 %. Zhvlerësimi ngarkohet me anë të metodës drejtvizore gjatë jetës së dobishme të pasurive.

### Kërkohet:

- Llogarisni vlerën e tanishme neto (VTN/NTV) të blerjes së makinerisë së re dhe komentoni gjetjet tuaja. (12 pikë)
- Llogarisni normën e kthimit para tatimit të kapitalit të përdorur (norma kontabël e kthimit) duke u bazuar në investimin mesatar dhe komentoni gjetjet tuaja. (7 pikë)
- Diskutoni pikat e forta dhe pikat e dobëta të normës së brendshme të kthimit për vlerësimin e investimeve kapitale. (6 pikë)

(Totali: 25 pikë)

## Zgjidhja e problemit 2

Vlerësimi i investimit me anë të vlerës së tanishme neto (VTN/NVT).

Norma nominale e zbritjeve (skontimit) duke përdorur efektin Fisher:  $1.0572 \times 1.05 = 1.1006$  **pra 11 %**

	1	2	3	4	5
<b>NJESITE</b>	35000	40000	50000	25000	
<b>CMIMI BAZE</b>	12	12	12	12	
<b>KV- BAZE</b>	7.8	7.8	7.8	7.8	
<b>TE HYRAT(me inflacion)</b>	<b>432,600</b>	<b>509,232</b>	<b>655,636</b>	<b>337,653</b>	<b>6,381</b>
<b>KV (me inflacion)</b>	<b>283,920</b>	<b>337,459</b>	<b>438,697</b>	<b>228,122</b>	
<b>SHF (me inflacion)</b>	26,500	28,090	29,775	31,562	
<b>RRJEDHA NETO E PARASE</b>	<b>122,180</b>	<b>143,683</b>	<b>187,164</b>	<b>77,968</b>	<b>6,381</b>
<b>TATIMET DIREKTE (pagesa 30% - 1 vit me vonese)</b>		<b>36,654</b>	<b>43,105</b>	<b>56,149</b>	<b>23,390</b>
<b>PERFITIMET TATIMORE (1 vit me vonese)</b>		18,750	14,063	10,547	30,141
<b>RR NETO PAS TATIMEVE NGA LEJIMET</b>	<b>122,180</b>	<b>125,779</b>	<b>158,122</b>	<b>32,366</b>	<b>13,132</b>
<b>SKONTIMI (11%)</b>	0.901	0.812	0.731	0.659	0.593
<b>VLERA E TANISHME</b>	<b>110,084</b>	<b>102,132</b>	<b>115,587</b>	<b>21,329</b>	<b>7,787</b>
<b>TOTAL VT</b>	<b>356,920</b>				
<b>TOTAL INVESTIM</b>	250,000				
<b>NVT</b>	<b>106,920</b>				

Meqenëse VTN është pozitive, blerja e makinerive është e pranueshme nga ana financiare.

### Llogaritjet

(L1) Viti	1	2	3	4
Kërkesa (njësi)	35,000	40,000	50,000	25,000
Çmimi i shitjes (€/njësi)	12.36	12.73	13.11	13.51
Shitjet (€/vit)	432,600	509,232	655,636	337,653
(L1) Viti	1	2	3	4
Kërkesa (njësi)	35,000	40,000	50,000	25,000
Kostot variabël (€/njësi)	8.11	8.44	8.77	9.12
Kostot variabël (€/vit)	283,920	337,459	438,697	228,122

(L13) Viti	Lejime kapitale		Përfitimet tatimore
1	250,000 x 0.25	= 62,500	62,500 x 0.3 = 18,750
2	62,500 x 0.75	= 46,875	46,875 x 0.3 = 14,063
3	46,875 x 0.75	= 35,156	35,156 x 0.3 = 10,547
4	Nga ndryshimi	100,469	100,469 x 0.3 = 30,141
		-----	-----
	250,000 - 5,000	= 245,000	73,501

(b) Llogaritja e normës së kthimit para tatimeve për kapitalin e përdorur

Rrjedhja neto totale e parasë së gatshme para tatimeve = 122 + 143 + 187 + 78 = €530,000

Zhvlerësimi total = 250,000 - 5,000 = €245,000

Fitimi vjetor mesatar kontabël = (530 - 245) / 4 = €71,250

Investimi mesatar = (250,000 + 5,000) / 2 = €127,500

Norma e kthimit nga kapitali i përdorur = 100 x 71,250 / 127,500 = 56 %

Duke pasur parasysh se norma e synuar të kthimit nga kapitali i përdorur i ABC sh. p. k. është 20 % dhe ROCE e investimit është 56 %, rekomandohet blerja e makinerisë.

(c) Një nga pikat e forta të normës së brendshme të kthimit (NBK/IRR) si një metodë e vlerësimit të investimeve kapitale është që ajo është një metodë e rrjedhjeve të skontuar të parasë së gatshme (RrSPG/DCF) dhe në këtë mënyrë merr parasysh vlerën e parasë në kohë. Në të njëjtën kohë mbahen parasysh edhe rrjedhjet e parasë së gatshme gjatë gjithë jetës së projektit dhe është sensitive si për sa i takon shumës ashtu edhe kohës së rrjedhjeve të parasë së gatshme. Ajo preferohet nga disa analistë për arsye se ofron një masë relative të vlerës së një investimi të propozuar, pra metoda llogarit një përqindje e cila mund të krahasohet me koston e kapitalit të kompanisë, dhe me ndryshore ekonomike të tilla si norma e inflacionit dhe normat e interesit.

Megjithatë NBK/IRR ka disa pika të dobëta si një metodë e vlerësimit të investimeve kapitale. Meqenëse është një masë relative e vlerës së investimit, ajo nuk mat rritjen absolute të vlerës së kompanisë (dhe në këtë mënyrë të pasurive të aksionarëve), të cilat në fakt mund të gjenden duke përdorur metodën e vlerës së tanishme neto (VTN). Një problem i mëtejshëm del në pah gjatë kohës kur vlerësohen projekte jo - tradicionale (në të cilat rrjedhjet e parasë së gatshme ndryshojnë nga pozitive në negative gjatë kohës - zgjatjes së projektit). NBK/IRR ofron aq vlera NBK/IRR sa herë ndryshojnë vlerat e rrjedhjeve të parasë së gatshme, gjë e cila nxjerr në pah vështirësi për sa i takon vlerësimit. Ky është edhe një konflikt potencial midis NBK/IRR dhe VTN në vlerësimin e projekteve që përjashtojnë njëri - tjetrin, rast në të cilin të dy metodat ofrojnë këshilla konfliktuoze për sa i takon faktit se cili nga projektet do të duhet të preferohet. Në rastet kur ka konflikte, VTN - ja gjithmonë ofron këshillat e duhura për sa i takon investimeve: jo NBK/IRR, megjithëse këshillat e dhëna edhe mund të ndryshohen duke pasur parasysh projektin që ka NBK/IRR - në më të madhe. Në këtë mënyrë ka disa arsye se pse NBK/IRR mund të shihet si një metodë inferior e vlerësimit të investimit në krahasim me alternativën e vet të rrjedhjeve të skontuara të parasë së gatshme, VTN - në.



### Problemi 3

ABC është një kompani private e cila specializohet në prodhimin e pajisjeve të ndriçimit. Ajo furnizon me pajisje për ndriçim klientët e saj të cilëve i'u duhen mesatarisht, 30 ditë për të paguar. Ajo ka një mbitërheqje bankare nga llogaria e vet rrjedhëse me vlerë € 2 milion. Norma e përbërë vjetore e interesit që i ngarkohet kësaj llogarie është 12%, ndërsa interesi i ngarkohet llogarisë çdo ditë. Në mënyrë që të reduktojë mbitërheqjen bankare, Drita tani është duke konsideruar ofrimin e zbritjeve për klientët që paguajnë brenda shtatë ditëve.

#### *Kërkohet:*

**(a) Llogarisni zbritjen maksimale që mund të ofrojë Drita për pagesat brenda shtatë ditëve në qoftë se kërkon të shmangë rritjen e kostove të saj të përgjithshme të financimit dhe shpjegoni bazat e llogaritjeve tuaja.** (6 pikë)

**(b) Shpjegoni shkurtimisht ndryshimin midis normës së thjeshtë dhe të përbërë të interesit, duke përdorur interesin e mbitërheqjes bankare të Dritës si një shembull.** (6 pikë)

(c) Një vit më vonë, pavarësisht se klientëve i është dhënë një zbritje e mirë, Drita sheh se shumë pak klientë kanë paguar herët duke përfituar nga zbritja. Në fakt, ditët e të arkëtueshmeve janë rritur në mënyrë domethënëse, njësoj si mbitërheqja bankare e kompanisë. Drita është pra duke shqyrtuar faktorimin e borxheve të saj vitin e ardhshëm. Shitjet me kredi për vitin e kaluar kapnin totalin € 12 milion, ndërsa të arkëtueshmet mesatare ishin € 2 milion. Vitin e ardhshëm, shitjet pritet të rriten me 10 %. Ditët e të arkëtueshmeve pritet të rriten deri në 70 ditë në qoftë se kompania NUK hyn në marrëveshjen e faktorimit.

(Një kompani që kryen shërbime faktoringu ka paraqitur propozimet e mëposhtme tek Drita:

- (i) Ditët e të arkëtueshmeve do të reduktohen në 28 ditë si rezultat i procedurave më të rrepta të kontrollit të kreditit.
- (ii) Faktori do të ngarkojë shpenzime interesi prej 13 % në vit për avancat e dhëna.
- (iii) Faktori do të ngarkojë një tarifë administrimi prej 1.5 % të qarkullimit për shërbimin e dhënë.
- (iv) Faktori do të paguajë në avancë 80 % të vlerës së faturave të shitjeve.

Në qoftë se Dritë - Hija do të hyjë në marrëveshje, kontrolli i saj mbi kreditë do të jetë i tepërt. Drejtoresha e kompanisë fiton një pagë prej € 18,000 në vit. Normat aktuale të mbitërheqjes bankare kanë mbetur të njëjta me 12 % në vit.

#### *Kërkohet:*

**Vlerësoni faktin nëse do të ishte mirë financiarisht për Dritë - Hijen të bënte faktoringun e borxhe të saj në vitin e ardhshëm.** (13 pikë)

**(Totali: 25 pikë)**

### Zgjidhja e problemit 3

#### *(a) Zbritja maksimale*

Norma efektive e interesit për 23 (30 - 7) ditë është:  $(1 \cdot 1223/365 - 1) \times 100 = 0 \cdot 717 \%$   
zbritja maksimale që duhet të ofrojë Drita, në qoftë se nuk dëshiron të rrisë kostot e saj të financimit, është 0.717 %.

#### *Shpjegim*

Në qoftë se klientëve do t'iu jepet një zbritje në qoftë se paguajnë brenda shtatë ditëve, Drita është efektivisht duke paguar për të marrë para të gatshme 23 (30 - 7) ditë më herët. Në këtë mënyrë, në mënyrë që të llogaritet zbritja maksimale që duhet t'i ofrohet klientëve meqenëse po paguajnë brenda shtatë ditëve, është e nevojshme të llogaritet norma efektive e interesit që po paguan Drita mbi mbitërheqjen e saj bankare për një periudhë prej 23 ditësh. Kjo shifër me pas duhet të jetë shuma maksimale që duhet t'i ofrojë Drita klientëve të saj për pagesë të hershme.

#### *(b) Normat e interesit*

Drita ka një normë të përbërë vjetore të interesit prej 12 %, ndërsa interesi i ngarkohet çdo ditë llogarisë së saj. Kjo normë prej 12 % në këtë mënyrë mban parasysh faktin se, çdo vit, interesi jo vetëm që i ngarkohet llogarisë së shumës që duhet të shlyhet por në të njëjtën kohë edhe të gjithë interesit i cili i debitet llogarisë rrjedhëse çdo ditë. Në këtë mënyrë, ky lloj interesi quhet interes i përbërë, për shkak se ai paguhet EDHE mbi kapitalin edhe MBI interesin gjatë gjithë vitit.

Nga ana tjetër norma 'e thjeshtë' e interesit, merr si bazë vetëm interesin e pagueshëm mbi të gjitha shumat e kryegjësë. Pra në rastin e Dritë - Hijes, në të nuk mbahet parasysh interesi i pagueshëm i cili i ngarkohet interesit i cili i kreditohet çdo ditë llogarisë së Dritë - Hijes. (Vini re: Një gjë e tillë mund të demonstrohet duke përdorur numra.)

#### *(c) A duhet të përdorë një faktor*

Kostot ekzistuese të financimit me 12 %	€
Shifra e re e shitjeve (€12 milion x 1.1)	13,200,000
Të arkëtueshmet (€13,200,000 x 70/365)	2,531,507
Kostoja e mbitërheqjes bankare në vit me 12 %	303,781
	-----

## Kostoja e faktoringut

Shitjet	13,200,000
Të arkëtueshmet që zvogëlohen në 28 ditë: €13,200,000 x 28/365	1,012,603
	-----
80 % i avancave nga faktori me 13 %: €1,012,603 x 80 % x 13 %	105,311
20 % që ende financohen nga mbitërheqja bankare: €1,012,603 x 20 % x 12 %	24,302
Tarifat e administratës: €13,200,000 x 1.5 %	198,000
Pagat e kursyera	(18,000)
	-----
	309,613
	-----
Kostoja shtesë e faktoringut	(5,832)
	-----

## Përfundim

Nuk është e pranueshme nga ana financiare që Drita të faktorojë borxhet e saj meqenëse nga kjo punë do të ketë kosto shtesë prej €5,832.

#### Problemi 4

Menaxhmenti i kompanisë ABC është duke konsideruar blerjen e një makine të re që kushton €220,000. Makina e re do të gjeneroi neto rrjedhje të parasë së gatshme prej €75,000 secilin vit për 4 vite me radhë. Në fund të vitit të katërtë makina do të shitet për €40,000. Kompania ka 5% kosto të kapitalit. Zhvlerësimi është 30% sipas saldos zbritëse ndërsa tatimi në korporata është 40%. Sipas regjimit për tatimin në korporata, 50% e tatimit paguhet në vitin kur fitimi është realizuar dhe 50% në vitin vijues.

*Shënim:* Zhvlerësimi dhe kursimet në tatim nga zhvlerësimi do të kanë efekt në rrjedhjen e parasë në përputhshmëri me regjimin e pagesës së tatimit.

#### Kërkohet:

- a) Llogaritni zhvlerësimin dhe kursimet në tatim nga zhvlerësimi në përputhshmëri me regjimin e pagesës së tatimit. 6 pikë
- b) Llogaritni tatimin në fitim. 3 pikë
- c) Llogaritni vlerën neto të tanishme (VTN) të projektit. 5 pikë
- d) Supozoni se kompania duhet të paguaj €10,000 për largimin e makinës së vjetër për të instaluar makinën e re. Kostoja e largimit do të trajtohet si pjesë e koston së makinës së re. Llogaritni vlerën neto të tanishme (VTN/VNT\_ të projektit nën rrethanat e reja. 6 pikë
- e) Shpjegoni se çfarë është analiza e ndjeshmërisë. Si ajo mund të ndihmoj në vendimet e buxhetimit të kapitalit? 5 pikë

	1.00%	2.00%	3.00%	4.00%	5.00%	6.00%	7.00%	8.00%	9.00%	10.00%
1	0.9901	0.9804	0.9709	0.9615	0.9524	0.9434	0.9346	0.9259	0.9174	0.9091
2	0.9803	0.9612	0.9426	0.9246	0.9070	0.8900	0.8734	0.8573	0.8417	0.8264
3	0.9706	0.9423	0.9151	0.8890	0.8638	0.8396	0.8163	0.7938	0.7722	0.7513
4	0.9610	0.9238	0.8885	0.8548	0.8227	0.7921	0.7629	0.7350	0.7084	0.6830
5	0.9515	0.9057	0.8626	0.8219	0.7835	0.7473	0.7130	0.6806	0.6499	0.6209
6	0.9420	0.8880	0.8375	0.7903	0.7462	0.7050	0.6663	0.6302	0.5963	0.5645
7	0.9327	0.8706	0.8131	0.7599	0.7107	0.6651	0.6227	0.5835	0.5470	0.5132
8	0.9235	0.8535	0.7894	0.7307	0.6768	0.6274	0.5820	0.5403	0.5019	0.4665
9	0.9143	0.8368	0.7664	0.7026	0.6446	0.5919	0.5439	0.5002	0.4604	0.4241
10	0.9053	0.8203	0.7441	0.6756	0.6139	0.5584	0.5083	0.4632	0.4224	0.3855

(Totali: 25 pikë)

## Zgjidhja e prolemit 4

a) Llogaritja e zhvlerësimit dhe efektet në rrjedhjen e parasë:

Viti	Vlera	Kursimet në tatim nga zhvlerësimi 40%	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5
	220,000						
Viti 1 - zhvlerësimi (30%)	66,000	26,400	<u>13,200</u>	13,200			
	154,000		<u>13,200</u>				
Viti 2 - zhvlerësimi (30%)	46,200	18,480		<u>9,240</u>	9,240		
	107,800			<u>22,440</u>			
Viti 3 - zhvlerësimi (30%)	32,340	12,936			<u>6,468</u>	6,468	
	75,460				<u>15,708</u>		
Rrjedhja e parasë nga shitja	40,000	14,184				<u>7,092</u>	<u>7,092</u>
Viti 4 - zhvlerësimi (30%)	35,460					<u>13,560</u>	<u>7,092</u>

b) Llogaritja e tatimit në fitim dhe orari i pagesës:

Viti 1	Fitimi €75,000 x tatimi 40% = €30,000	50% e pagueshme në vitin 1	€15,000
		50% e pagueshme në vitin 2	€15,000
Viti 2	Fitimi €75,000 x tatimi 40% = €30,000	50% e pagueshme në vitin 2	€15,000
		50% e pagueshme në vitin 3	€15,000
Viti 3	Fitimi €75,000 x tatimi 40% = €30,000	50% e pagueshme në vitin 3	€15,000
		50% e pagueshme në vitin 4	€15,000
Viti 4	Fitimi €75,000 x tatimi 40% = €30,000	50% e pagueshme në vitin 4	€15,000
		50% e pagueshme në vitin 5	€15,000

c) Llogaritja e vlerës neto të tanishme të projektit

Viti	Makina	Kursimet në tatim nga zhvlerësimi	Fitimi	Tatimi në fitim	Totali i rrjedhjeve të parasë	5% Faktori skontues	Vlera e tanishme
0	-220,000				-220,000	1.0000	-220,000
1		13,200	75,000	-15,000	73,200	0.9524	69,716
2		22,440	75,000	-30,000	67,440	0.9070	61,168
3		15,708	75,000	-30,000	60,708	0.8638	52,440
4	40,000	13,560	75,000	-30,000	58,560	0.8227	48,177
5		7,092		-15,000	-7,908	0.7835	<u>-6,196</u>
VNT							<u>5,305</u>

d) Llogaritja e vlerës neto të tanishme të projektit duke marr parasysh €10,000 shpenzime shtesë:

i. Llogaritja e zhvlerësimit dhe efektet në rrjedhjen e parasë

Viti	Vlera	40% Kursimet në tatim nga zhvlerësimi	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5
	230,000						
Viti 1 - zhvlerësimi (30%)	69,000	27,600	<u>13,800</u>	13,800			
	161,000		<u>13,800</u>				
Viti 2 - zhvlerësimi (30%)	48,300	19,320		<u>9,660</u>	9,660		
	112,700			<u>23,460</u>			
Viti 3 - zhvlerësimi (30%)	33,810	13,524			<u>6,762</u>	6,762	
	78,890				<u>16,422</u>		
Rrjedhja e parasë nga shitja	40,000	15,556				<u>7,778</u>	<u>7,778</u>
Viti 4 - zhvlerësimi (30%)	38,890					<u>14,540</u>	<u>7,778</u>

ii. Llogaritja e tatimit në fitim dhe orari i pagesës:

Viti 1	Fitimi €75,000 x tatimi 40% = €30,000	50% e pagueshme në vitin 1	€15,000
		50% e pagueshme në vitin 2	€15,000
Viti 2	Fitimi €75,000 x tatimi 40% = €30,000	50% e pagueshme në vitin 2	€15,000
		50% e pagueshme në vitin 3	€15,000
Viti 3	Fitimi €75,000 x tatimi 40% = €30,000	50% e pagueshme në vitin 3	€15,000
		50% e pagueshme në vitin 4	€15,000
Viti 4	Fitimi €75,000 x tatimi 40% = €30,000	50% e pagueshme në vitin 4	€15,000
		50% e pagueshme në vitin 5	€15,000

iii. Llogaritja e vlerës neto të tanishme të projektit

Viti	Makina	Kursimet në tatim nga zhvlerësimi	Fitimi	Tatimi në fitim	Totali i rrjedhjeve të parasë	5% Faktori skontues	Vlera e tanishme
0	-230,000				-230,000	1.0000	-230,000
1		13,800	75,000	-15,000	73,800	0.9524	70,287
2		23,460	75,000	-30,000	68,460	0.9070	62,093
3		16,422	75,000	-30,000	61,422	0.8638	53,056
4	40,000	14,540	75,000	-30,000	59,540	0.8227	48,984
5		7,778		-15,000	-7,222	0.7835	<u>-5,658</u>
VNT							<u>-1,238</u>

- e) Analiza e ndjeshmërisë ndryshon supozimet mbi të cilat bazohet analiza e investimit të kapitalit dhe vlerëson efektin mbi tiparin e rrjedhjes së parasë. Në vendimet për investime kapitale, analiza e ndjeshmërisë mund të përdoret për të ndihmuar në vlerësimin e rrezikut të një projekti. Pasiguria në rrjedhjet e parashikuara të parasë së gatshme mund të trajtohen duke ndryshuar parashikimet për të parë se sa i ndjeshëm është një vendim në gabimet në vlerësime.